



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0083

V.M.

Paditësit/Ankuesit

S.M.

H.M.

N.M.dhe

M.M., të gjithë nga Malisheva,
të cilët i përfaqëson avokati,

Kundër :

NSH KB "M "Malishevë,

E paditura

përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, (AKP), Rr."Agim
Ramadani", nr.23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-12-0369 të datës 14 prill 2016, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësve , refuzohet si e pabazuar,**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së , C-III-12-0369 të datës 14 prill 2016.**

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 27 dhjetor 2011, paditësit parashtruan padi pranë Gjykatës Komunale në Malishevë (tani degë e Gjykatës Themelore në Gjakovë), me të cilën kërkuan që ti ju njihet e drejta e pronësisë së ngastrës kadastrale nr. 144, në sipërfaqe prej 01.56.00 ha, në vendin e quajtur "S", ngastrës kadastrale nr. 74, në sipërfaqe prej 01.41.00 ha, në vendin e quajtur "AB", ngastrës kadastrale nr. 84, në vendin e quajtur 01.10.00 ha, në vendin e quajtur "R" dhe ngastrës kadastrale nr. 88, në sipërfaqe prej 0.55.00 ha, në vendin e quajtur "R", të gjitha këto ngastra kadastrale sipas vitit 1959 të regjistruara sipas listës poseduese nr. 20. Paditësit më tutje kërkojnë që të obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që ngastrat kontestuese të regjistrohen në emër të paditësve. Përfundimisht kërkuan kompensimin e shpenzimeve gjyqësore. Paditësit pohuan se, paraardhësi i tyre, tani i ndjerë Z.M. ishte pronar i ngastrave kadastrale kontestuese gjer me 1963, e të cilat më vonë janë konfiskuar nga pushteti i atëhershëm dhe i janë dhënë të paditurës.

Paditësit me padi, parashtruan Aktvendimin, nr 18-765/1-67, të datës 2 qershor 1974, procesverbalin e datës 24 nëntor 1963, kërkesa për revizion, procesverbalin si dhe aktvendimin nr. 1467 të datës 24 nëntor 1963, një listë me emra të personave fizik të ndryshëm, certifikatën mbi të drejtat pronësore të datës 12 korrik 2011, aktvendimin mbi trashëgiminë dhe kopje të historiatit të pronës kontestuese të datës 22 tetor 2015.

Me 23 shkurt 2012, Gjykatat Komunale në Malishevë me Aktvendimin e saj C.nr. 152/2011 shpallet jokompetente dhe lëndën e referon për vendosje pranë DHPGJS. Lënda në DHPGJS merr numrin C-III-12-0369.

AKP, me anë të mbrojtjes së saj të datës 14 prill 2014, i propozoj DHPGJS-së që padinë e paditëseve ta refuzoj si të pabazuar. Sipas mbrojtjes, së AKP, paditësit në bazë të evidencës së parashtruar me padi shihet se paraardhësi i tyre, bazuar në Vendimin e komisionit për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore, lëshuar me

1972, i është kompensuar prona kontestuese dhe në bazë të këtij fakti paditësit nuk gëzojnë të drejtën e pronësisë së pronës kontestuese.

Më 12/02/2016 ishte mbajtur seanca dëgjimore në të cilën morën pjesë, palët u dhe përfaqësuesit e tyre.

Paditësit fillimisht parashtruan Aktvendimin mbi trashëgiminë për të ndjerin, Z.M. si dhe kopjen e Historiatit të pronës kontestuese. Paditësit po ashtu në fjalën e tyre hyrëse ndryshuan padinë e tyre, në kuptimin subjektiv, ashtu që paditësit tërhoqën padinë ndaj të paditurit të parë, M.K.. Më tutje si paditësi ashtu edhe e paditura mbetën në tërësi pranë pretendimeve të tyre si në padi respektivisht mbrojtjes në padi.

Me 19 shkurt 2016, AKP deklaroi se prona kontestuese nuk është e privatizuar dhe se evidentohet në emër të paditurës, NSH M me nr. 119/17. Certifikata e pronësisë nr.23-1423të datës 11/07/2014.

Më datën 14 prill 2016 Kolegji i Specializuar merr Aktgjykimin C-III-12-0369, në të cilën padia e paditësve V. Z.M., nga Malisheva, S.M., nga Malisheva, H.Z.M., nga Malisheva, N.M. nga Malisheva, refuzohet si e pabazuar, me arsyetim se paditësit dështuan që të parashtrojnë dëshmi lidhur me pohimet e tyre mbi shpronësimin joligjor, si dhe nuk i sqaruan mosveprimet e tyre pranë Gjykatës lidhur me kompensimin monetar, ndërsa, padia ndaj të paditurit M.K. konsiderohet e tërhequr dhe nuk janë caktuar taksa gjyqësore .

Më datën 27 prill 2016 kundër Aktgjykimit C-III-12-0369 të paditësit (më tutje ankuesit) paraqiten ankesë për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJ-së të prish Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim. Ankuesit pohuan se Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të nenit 181 paragrafi 1 dhe nenit 183 paragrafi 2 i LPK-së, duke mos u bazuar në provat e paraqitura në vendimet e vitit 1963,1967 dhe 1974. Gjithashtu ata pohuan se kanë atakuar vendimin por nga struktura e atëhershme nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje. Ankesës ia bashkëngjiten edhe parashtrësën, Informacion, të përkthyer në gjuhën shqipe.

Më 22/07/2016, ankuesit kanë parashtruar edhe kopjen e origjinalit të parashtrësës informacion edhe në gjuhën Serbe.

Më datën 04/12/2018, AKP jep përgjigje në ankesë, duke e kundërshtuar ankesën e ankueseve si të pabazuar me ligj ,sepse ankuesi nuk ka mundur të konstatoj një tjetër gjendje faktike prej asaj siç ka vërtetuar Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së. AKP i propozon Kolegji të Apelit që ankesën e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar në ligj dhe të vërtetoj Aktgjykimin e Kolegjit të specializuar.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj ai duhet të vërtetohet. Argumentimi ligjor që e përdorë Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në Aktgjykimin e ankimuar është i saktë dhe ai pranohet edhe nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vlerëson se nuk mund të pranohen si të sakta pretendimet e ankuesit se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, se nuk është vërtetuar drejtë dhe saktë gjendja faktike dhe se është aplikuar gabimisht ligji material. Gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar drejtë dhe arsytet në bazë të cilave është refuzuar padia janë të sakta.

Është fakt i pa kontestuar se toka e pretenduar nga paditësit, është e regjistruar në emër të paditurës, që dëshmohet në bazë të deklaratës së AKP-së në parashtrësën e datës 19/02/2016 dhe Certifikatës së pronësisë nr. 23-1423 të datës 11/07/2014 e cila është në dosje. Gjithashtu është fakt i provuar nga

gjykata e shkallës së parë se paraardhësi i paditësve M.M. i ishte njohur e drejta e pronësisë ndaj patundshmërisë kontestuese. Siç ka konkluduar saktë Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e ankimuar, Aktvendimi i Komisionit nr. 765/1-67 i datës 02 qershor 1974 ia njuh të drejtën e pronësisë paraardhësit të paditësve M.M. ndaj pronës kontestuese. Njëkohësisht me të njëjtin vendim ai shpronësohet nga pronësia me të drejtë kompensimi monetar në shumën e caktuar në pikën tre të dispozitivit të këtij vendimi. Rrjedhimisht ky vendim dëshmon se paraardhësit të paditësit, ishte shpronësuar, me të drejtë ankimimi, kundërshtimi, vetëm për shumën e caktuar si kompensim, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Prandaj Kolegji i Specializuar ka zbatuar drejt dispozitat e Ligjit mbi Rregullimin e marrëdhënieve pasurore juridike nr. 25/73 duke u njohur vetëm të drejtën e kompensimit monetarë. Paditësit, përveç aspektit deklarativ me asnjë provë nuk arritën të dëshmojnë se këtë vendim e kanë kundërshtuar para një organi kompetent. Parashtresa e parashtruar me ankesë, Informacion, paraqet vetëm një konstatim mbi gjendjen e patundshmërive të ngastrave të njëjta në përgjithësi në territorin e Komunën së Klinës. Kjo parashtresë nuk paraqet veprim konkret të paditësve lidhur me pronën kontestuese dhe si të tillë Kolegji i Apelit nuk mund të konsideroj si veprim të paditësve drejtuar organeve kompetente lidhur me kompensimin monetarë.

Andaj Kolegji Apelit e vlerëson si të saktë përfundimin e Kolegjit të Specializuar se paditësi ka dështuar të provojë me prova relevante se paraardhësi i tij ligjor M.M. kishte një titull të duhur pronësorë për patundshmërinë kontestuese. Ai kishte vetëm të drejtën në kompensim monetarë .

Nga pikëpamja e dispozitave ligjore, paditësit nuk mund të gëzojnë të drejtën për kompensim monetar, pasi që një kompensim i tillë nuk është kërkuar brenda afatit të paraparë në Vendim.

Në bazë të këtyre arsyeve, ankesa e ankuesve refuzohet si e pa bazuar, ndërsa Aktgjykimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore. Ai tashmë ka paguar taksën gjyqësore dhe atë më 13/05/2016.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJS, me datë 26 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Ankuesit,
- E paditura,
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-III-12-0369

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
